

# Integrimi

## ZGJIDHJA

		USHQIMI				HOBI				XHAKETA			
		Sanduiç	Petë	Hamburger	Vezë	Fjalëkryq	Shkrim	Lexim	Fotografi	E bardhë	E verdhë	E kaltër	E kuqe
EMRI	Petriti												
	Dea												
	Burimi												
	Agimi												
XHAKETA	E bardhë												
	E verdhë												
	E kaltër												
	E kuqe												
HOBI	Fjalëkryq												
	Shkrim												
	Lexim												
	Fotografi												

Petriti, Dea, Burimi dhe Agimi janë studentë të fakultetit të mjekësisë. Ata kohën e lirë, zakonisht e kalojnë në park duke u marrë çdonjëri me aktivitet e veta. Sot patën një pauzë prej 2 orësh dhe pasi ishte koha e mirë, çdonjëri prej tyre kishte sjellë ushqim. Në bazë të të dhënave të mëposhtme, mundohuni të zbuloni se cili (cila) ka fanellë të kuqe dhe cili (cila) e ka pasion fotografimin?! Rezultatet i shënoni në tabelën poshtë.

### Të dhënat:

- Petriti është ulur në anën e majtë dhe ha sanduiç.
- Dea njëkohësisht e mbush fjalëkryqin dhe ha petë.
- Personi me xhaketë të bardhë është femër.
- Burimi ka xhaketë të verdhë.
- Ai që ha hamburger merret me shkrime.
- Personi që ha petë është ulur pranë Petritit.
- Burimi është ulur pranë atij që ha vezë.
- Personi i ulur pranë asaj me xhaketë të bardhë i do vezët.
- Agimi e ka merak leximin.
- Xhaketën e kaltër e ka personi që rri në të djathtë të vajzës.

### TABELA

	Ushqimi	Hobi	Xhaketa
Petriti			
Dea			
Burimi			
Agimi			